

Nr. _____ Prot

Berat, me ____/____/2023

PROCES-VERBAL Nr. 1

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim sigurie i ruajtjes fizike të ndërtesave, aseteve, dhe njerëzve te Drejtorise Rajonale te OSSH sh.a, Berat & FSHU sh.a, Berat” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79713000-5, 66515000-3 Shebim me roje private, per sigurimin ne rast demi ose humbje

VLERA E FONDIT LIMIT: 142, 729, 982 (njëqind e dyzetë e dy milion e shtatëqind e njëzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH, Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros për te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve, te jete jo me e vogel se 80 % të fondit total limit te marreveshjes kuader.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

OE ofertues duhet te kete kapacitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve, te jete jo me e vogel se 80 % të fondit total limit te marreveshjes kuader.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje te vërtetuar te bilanceve, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëse te Administratës Tatimore, te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022) ku te pakten ne dy bilance te njepasnjeshme, nuk ka raport negative ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Akt Ekspertizen te Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40 % të vlerës së fondit total limit të Marreveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke pasur parasysh se shërbimi i sigurie për ruajtjen e ndërtesave, asetëve, njerezve dhe pronave është një shërbim shumë i rëndësishëm, është parë e arsyeshme që operatori ekonomik duhet të ketë eksperiencë të mëparshme për të garantuar shërbimin e kërkuar dhe për të vërtetuar aftësitë e tij.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si më poshtë:

- a) Licenca për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë, kategoria I.3.A lëshuar nga QKB.

- b) Certificate e "Titullarit të Subjektit" te shoqerise, leshuar ne baze te ligjit nr.75/2014.
- c) Certificate e "Drejtuesit Teknik" të shoqerisë, leshuar ne baze te ligjit nr.75/2014.
- ç) Certificate e "Punonjesit te Sherbimit" për jo me pak 52 punonjës shërbimi gjithesej te nenkategorise I.3.A, nga te cilat 34 punonjes sherbimit te certifikuar nga DPQ Berat dhe 18 punonjes sherbimit te certifikuar nga DPQ Fier ne baze te ligjit nr.75/2014.
- d) Autorizim individual ne emer te shoqerise, lëshuar nga AKEP, për Përdorimin e Frekencave për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, me zonë mbulimi të tillë që të përfshijë hapsirën ku ndodhen objektet e Drejtorise ne Skrapar, Polican, Berat, Kucove, Lushnje dhe Divjake dhe/ose me dokumentacion qe provon menyra te tjera nderlidhje (si psh. kontrata me operator te telefonise mobile/levizshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe ligjit.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike"

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Operatori ekonomik te paraqese vërtetim nga Drejtorite e Policive Vendore te Qarqeve Berat dhe Fier me date leshimi jo me pare se 30 dite nga data e hapjes se ofertave, ne te cilen pasqyrohet informacioni i meposhtem:

- a) Per numrin e punonjësve te certifikuar gjithesej per kategorinë I.3.A, jo me pak se 52 punonjës shërbimi nen-kategoria I.3.A, nga te cilat 34 punonjes sherbimi te certifikuar nga DPQ Berat dhe 18 punonjes sherbimi te certifikuar nga DPQ Fier ne baze te ligjit nr.75/2014.
- b) Te kete Pergjegjes Sherbimi, jo pak se 2 (dy), 1 (nje) ne Qarkun Berat dhe 1 (nje) ne Qarkun Fier.
- c) Te kete Grupe të Gatshëme punonjesisht për verifikim te sinjaleve te alarmit ne Qarkun Fier dhe Qarkun Berat.
- ç) Operatori ekonomik duhet te kete performance te mire gjate ushtrimit te aktivitetit. Nuk duhet te kete marre masa administrative per operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014, gjate viteve 2020, 2021, 2022. Per te provuar kete fakt duhet te paraqes vertetim/e te leshuara nga Drejtorite Vendore te Policise ne Qarqet Fier dhe Berat.
- d). Akti-Miratimi "Per qendren e Kontrollit te SHPSF" leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Berat dhe Drejtoria e Policise se Qarkut Fier, konform nenit nr. 22 te Ligjit nr.75/2014.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligji 75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike” .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Per Shërbimin e sigurie per ruajtjen e ndertesave, aseteve, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSSH, Berat, te cilat kane nje rendesi te vecante.

Me anë të kriterit (vërtetim i performancës nga DVP Berat dhe DVP Fier) kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë se plotësojnë kërkesat lidhur me stafin, kualifikimet dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit të aktivitetit.

- Kërkesa që vërtetimi i performancës të jetë lëshuar jo më vonë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave, është në përputhje me nenin 20 dhe nenin 24, gërma “e” të Ligjit nr. 75.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë” dhe ka për qëllim marrjen e informacionit aktual lidhur me këtë performancë.

- Lidhur me masat administrative dhe ngjarjet për periudhën 2020, 2021 dhe 2022:

Sipas pikës 4, të nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor në vendosjen e kriteve kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomik, të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet dhe besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë Autoriteteve Kontraktore për njohjen e gjendjes së kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetin organizativ, reputacionin dhe besueshmërinë si dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik zotërojnë të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe me cilësi.

Kërkesa lidhur me masat administrative për operatorin ekonomik (subjektin) dhe Drejtuesin Teknik parashikohen nga Kreu V i Ligjit nr. 75.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe në Kreun III të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë”, gjithashtu është dhe si rubrikë e vecantë , ashtu si dhe ngjarjet e ndodhura në objekt, edhe në Modelin e Performancës, miratuar nga Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018.

Kjo kërkesë bazohet në nenin 19 dhe 20 të Ligjit nr. 75.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” si dhe në Kreun III, pika “B” e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë”. Në këto dispozita parashikohet se është Drejtoria Vendore e Ploicisë struktura mbikëqyrëse që ka informacion të përnuajshëm lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike.

Sa i përket periudhës që kërkohet që të mos ketë masa administrative dhe ngjarje (vitet 2020, 2021 dhe 2022) është në koherencë dhe me kriteret e tjera (xhiron e realizuar dhe shërbimet e ngjashme të realizuara), për vetë rëndësinë e kërrij shërbimi, dhe synon përtëhjen në këtë procedurë prokurimi të operaqtorëve të cilët e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 54 persona**, 52 punonjes sherbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Gjithashtu OE duhet të paraqes vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Mars 2023, Prill 2023, Maj 2023), shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) të nxjerra nga sistemi elektronik të tatimeve. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 54 punonjës të siguruar në muaj, 52 punonjes sherbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Duke llogaritur numrin e objekteve për të cilat kërkohet sherbimi me roje, numri i vendrojeve si dhe orari i sherbimit duke përllogaritur turni I, II, dhe III.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 5 (pese) automjete të përshtatshme për ndërhyrje në raste emergjente dhe patrullim, në pronësi apo të marra me qera, të vërtetuara si më poshtë:

- Pronësia e automjeteve të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm.

- Marrja me qera ose huapërdorja e automjeteve të mesiperme, do të pranohet vetëm nëse kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të kontratës për këtë shërbim dhe të shoqëruara me dokumentacionin (lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 9 të DST-ve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Automjetet janë kërkuar për raste të nderhyrjes emergjente dhe patrullim nga Grupi i Gatshëm pranë objekteve që do të ruhen nga OE. Numri i automjeteve është kërkuar në bazë të numrit të objekteve që do të ruhen. Gjithsej janë 19 objekte. Dhe 5 automjetet e kërkuara nga AK janë të miftueshme për kryerjen e objektit të prokurimit.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një rojë dhe një vendroje në muaj). Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin e ofertës duke respektuar aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi (si p.sh: page baze, shtesat mbi page turni I+III, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nënë kostos ligjore dhe do të skualifikohen.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbimi do të kryhet për 8 orë me 1.43 rojë, 12 orë me 2.14 rojë dhe 24 orë me 4.98 rojë :

Shërbimi i ruajtjes fizike :

- Roja duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, me uniformë dhe dokument identifikues dhe mjete të tjera llogjistike siç parashikohet nga ligji 75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike” .

- Të ruaj objektin që i është besuar, të ruajë rendin në të si dhe të sigurojë jetën e personelit.

- Për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçanta, ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me armë krahu dhe për objektet e tjera me armë brezi, sipas përcaktimeve ligjore të ligjit.75/2014“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”

- Shërbimi i ruajtjes fizike do të fllojë në orën 08:00 në mëngjes, do të mbarojë në orën 16:00 për shërbimin 8 orë dhe në orën 20:00 në darkë për shërbimin 12 orësh. Shërbimi do të ofrohet nga e Hëna në të Shtunë.

Shërbimi i ruajtjes me Alarm.

- Shërbimi i ruajtjes me sistem alarmi do të ofrohet nga ora 16:00 deri në orën 08:00 në vendet ku shërbimi i ruajtjes fizike do të ofrohet 8 orë dhe nga ora 20:00 deri në orën 08:00 në vendet ku shërbimi i ruajtjes fizike do të ofrohet 12 orë, 24 orë ditë e pushimeve dhe festat zyrtare.

- Shërbimi i ruajtjes me sistem alarmi do të ofrohet për ambientet e brendshme të objekteve (sensor të brendshëm).

- Do të vendoset të paktën 1 (një) sistem alarmi për çdo objekt.

- Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambientin e marrë në sigurim.

- Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe çaktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.

- Shoqëria e Sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie (pas ardhjes së sinjalit të alarmit në monitor si pasojë e mosvlerësimit dhe vonësës në verifikim për më shumë se 5 minuta)

- Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.

- Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me Radio, me GSM ose me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastier me kod, me sensorë me kabëll ose me ëireless.

- Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, pajisjet e zëvendësuara, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit periodik dhe në periudhën e garancisë, do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme :

a) Të jetë i licensuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit si roje i ruajtjes dhe sigurisë fizike (kopje e licensës).

b) Të reflektojë një sjellje korrekte dhe të respektueshme.

- c) Paisja me mjet identifikimit si roje e ruajtjes dhe sigurisë fizike gjatë gjithë kohës së shërbimit duhet të mbahet në vend të dukshëm.
- d) Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjësi i kompanisë SHPSF duhet të respektojë rregullat e brendshme të OSSH sh.a.
- e) Punonjësi i ofruesit të shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe veprojë gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga OSSH.
- f) Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të publikuar në fletoren zyrtare datë 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.
- g) Të ushtrojnë kontrole të herë pas herëshme në objektin ku kryen shërbimin, për të parandaluar veprimet e kundërligjshme.
- h) Për persona të jashtëm që vijnë për probleme pune, duhet të njoftojnë më parë punonjësin që kërkohet dhe me lejen e tij i shoqërojnë tek ai.
- i) Të kërkojnë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.

NJESIA E PROKURIMIT

- | | |
|-----------------|--------------------|
| - Armando Roko | Personi përgjegjës |
| - Aldora Dume | Anëtare |
| - Bledar Dautaj | Anëtar |